



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr.1035/1 Prot.

Tiranë, më 17/07/ 2020

V E N D I M

Nr. 75, Datë 17 /07/ 2020

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, bazuar në nenin 32, pika 1, gërma “a”, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, mori në shqyrtim ankesën nr.62 regj, datë 30.06.2020, të paraqitur nga një grup personash dhe konkretisht znj.E.K, znj.E.B, znj.S.D, znj.K.N, z.Gj.H, znj.E.R, znj.F.P, znj.F.Xh, znj.A.J, znj.S.G, znj.Z.B, znj.Z.K, z.D.D, kundër Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, me pretendimin për diskriminim për shkak të aftësisë së kufizuar dhe gjendjes shëndetësore. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Ne që ju drejtohem, jemi një grup me prindër me fëmijë me aftësi të kufizuara dhe dëshirojmë t’ju njoftojmë në lidhje me një fakt që kërkon vëmendjen tuaj. Bëhet fjalë për projektvendimin “*Për përcaktimin e masës, kritereve, procedurave dhe dokumentacionit, për personat me aftësi të kufizuar si dhe të ndihmësit të tyre*”. Në këtë dokument në kreun III mbi masat e përfitimit të aftësisë së kufizuar, në pikën 8, thuhet se: “*Periudha e shërbimit si ndihmës personal, për personat e caktuar në pikën 1, shkronja C, të kreut I (.... “personat paraplegjikë dhe tetraplegjikë, të cilët deklarohen me vendim të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë se janë bërë të tillë, pavarësisht nga shkaku dhe mosha*”), i cili nuk është ekonomikisht aktiv, si dhe nuk përfiton të ardhura nga skema e sigurimit të detyrueshëm shoqëror, vlerësohet periudhë sigurimi, për efekt përfitimi pensioni, barrë lindje, aksidenti në punë, sëmundje profesionale dhe sigurimi shëndetësor. Kontributet paguhen në bazë të pagës minimale, për efekt të llogaritjes së kontributit të sigurimit të detyrueshëm shoqëror dhe përballohet nga buxheti i shtetit.”

¹Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

Në VKM është përcaktuar se vetëm për ndihmësit e kategorive të personave paraplegjik dhe tetraplegjik, periudha e shërbimit si ndihmës personal do të vlerësohet periudhë sigurimi, për efekt përfitimi pensioni, duke lënë jashtë disa kategori të tjera. Diferencimi i kategorive është i padrejtë, pasi ne, prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuara, në veçanti të fëmijëve me spektrin e autizmit, jemi po ashtu në kushte të vështira. Në shumicën e rasteve nuk mund të jemi ekonomikisht aktiv e në gjendje pune, për shkak të nevojës për përkujdesje me kohë të plotë ndaj këtyre fëmijëve. Fëmijët me autizëm hasin vështirësi në shkollë dhe shpesh herë nuk e frekuentojnë atë, edhe kur pranohen ata nuk qëndrojnë gjatë gjithë ditës, po ashtu nuk ka qendra me kapacitete të tilla për t'u kujdesur për ata. Kjo vlen jo vetëm për fëmijët në moshë të vogël por edhe për adoleshentët apo të rriturit me autizëm. Angazhimi jonë si ndihmës personal është një angazhim me kohë të plotë dhe i nevojshëm gjatë gjithë jetës për personat me AK për të cilët kujdesemi. Përballë kësaj situatë dhe në kushtet në të cilat ndodhemi, edhe ne e kemi krenarë të pamundur të gjejmë punë, të sigurojmë të ardhura por mbi të gjitha të kemi mundësi të paguajmë detyrimet dhe të kemi vjetërsi, kjo e bën të ardhmen tonë të pasigurt.

Lënia jashtë e kategorive të tjera të kujdestarëve personal, na ka vendosur në kushtet e diskriminimit dhe përbën një shqetësim të madh për ne.

Kërkesa jonë i drejtohet Komisionerit për të gjetur një zgjidhje për rastin tonë dhe të shumë prindërve si ne, si dhe angazhimit e strukturave përgjegjëse që të mundësohet përfshirja e kategorisë së ndihmësve personal të fëmijëve me autizëm në dokument dhe të vlerësohet periudha e shërbimit si ndihmës personal si periudhë sigurimi, për efekt përfitimi pensioni.

Përfundimisht ankuesit kërkojnë nga Komisioneri që të konstatojë diskriminimin dhe të rekomandojë Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale që të marri masa për zhdukjen e rrethanave diskriminuuese.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Në nenin 1, të Ligjit Nr.10 221/2010 *“Për mbrojtjen nga diskriminimi”* përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”*

Bazuar në nenin 3, pika 4, të Ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”* përcaktohet se: “Diskriminim për shkak të shoqërimit” është ajo formë diskriminimi që ndodh kur ka një dallim, kufizim ose preferencë, për arsye të shoqërimit me persona që u përkasin grupeve të

përmendura në nenin 1 të këtij ligji, si dhe për shkak të supozimit për një shoqërim të tillë.

Bazuar në nenin 7, pika 1, të Ligjit nr. 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, përcaktohet se: *“Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim.”*

Bazuar në nenin 20, pika 1, gërma “b”, të Ligjit nr. 10221/2010, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, përcaktohet se *“1. Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t’i arrijë ose t’i përdorë ato: a) duke refuzuar t’i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji; b) duke refuzuar t’i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi”.*

Bazuar në nenin 20, pika 2, gërma “c”, të Ligjit nr. 10221/2010, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, përcaktohet se: *“Pika 1 e këtij neni zbatohet veçanërisht për:c) kontributin dhe mundësinë për të përfutur të mira nga skemat e mbrojtjes shoqërore, duke përfshirë asistencë sociale, sigurime shoqërore, mbrojtje të fëmijëve, përfitim për shkak të aftësisë së kufizuar, apo ndonjë skemë tjetër të mbrojtjes sociale ose avantazh tjetër social të ofruar për publikun;.....”*

Gjatë shqyrtimit paraprak të ankesës dhe mbështetur në faktet dhe pretendimet e parashtruara nga ankuesit, Komisioneri vlerëson se bazuar në nenin 33, pika 4, gërma “b” të Ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi” ankesa nuk duhet të pranohet pasi e njëjta çështje është duke u shqyrtuar në kuadër të një ankese tjetër, për arsye të mëposhtme:

Ankesa është paraqitur kundër parashikimeve që bëhen në një projektvendim të titulluar “Për përcaktimin e masës, kriterëve, procedurave dhe dokumentacionit, për personat me aftësi të kufizuar si dhe të ndihmës të tyre” ku parashikohet se, vetëm për kujdestarët e personave paraplegjikë dhe tetraplegjikë të cilët nuk janë ekonomikisht aktivë, periudha e shërbimit si ndihmës personal do të vlerësohet si periudhë sigurimi për efekt përfitimi pensioni, ndërsa kujdestarët e kategorive të tjera të personave me aftësi të kufizuara, si në rastin konkret ankuesit që pretendojnë se janë kujdestarët e fëmijëve të tyre të cilët janë vlerësuar si persona me aftësi të kufizuar dhe që janë diagnostifikuar me autizëm, përjashtohen nga kjo e drejtë. Nga aktet shoqëruese të ankesës nuk rezulton që ankuesit të kenë depozituar kopje të projektvendimit që ata kundërshtojnë.

Nga verifikimet e kryera nga Komisioneri rezulton se, është miratuar VKM nr.182, datë 26.02.2020 “Për përcaktimin e masës, të kriterëve, procedurave e dokumentacionit për vlerësimin dhe përfitimin e pagesës për personat me aftësi të kufizuara, si dhe të ndihmës personal”. Në pikën 8, të Kreut II, të VKM nr. 182/26.02.2020, është parashikuar se : “Periudha e shërbimit si ndihmës personal për personat e përcaktuar në shkronjës “a”, të nenit 8, të ligjit nr. 57/2019, “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, të cilët nuk janë ekonomikisht aktivë dhe nuk përfitojnë të ardhura nga skema e sigurimit të detyrueshëm shoqëror, vlerësohet periudhë sigurimi, për efekt pensioni, barrë lindje, aksidenti në punë, sëmundje profesionale dhe sigurimi shëndetësor. Kontributet paguhen në bazë të pagës minimale, për efekt të llogaritjes së kontributit të sigurimit të detyrueshëm shoqëror, dhe përballohen nga buxheti i shtetit.”

Nga krahasimi i përmbajtjes së VKM-së nr. 182/26.02.2020, e në mënyrë të veçantë të pikës 8, të Kreut II, të saj dhe përmbajtjes së projektvendimit “Për përcaktimin e masës, kriterëve, procedurave dhe dokumentacionit, për personat me aftësi të kufizuara si dhe të ndihmës personal” që kundërshtohet nga ana ankuesit, rezulton se bëhet fjalë për të njëjtin akt.

Rezulton se me urdhrin nr.71, datë 16.06.2020, Komisioneri ka filluar procedurat për ndjekjen kryesisht të çështjes “Mbi përfitimin e pagesës për personat me aftësi të kufizuara dhe ndihmës personal”. Objekt i këtij hetimi të filluar kryesisht nga Komisioneri është pagesa dhe përfitimet e personave me aftësi të kufizuara dhe kujdestarëve të tyre sipas parashikimeve në VKM-në nr. 182/26.02.2020. Pra, rezulton se objekti i ankesës është i njëjtë me një pjesë të objektit të hetimit të filluar kryesisht nga Komisioneri, i cili në fakt është një hetim më i gjerë pasi shtrihet në tërësi mbi pagesën dhe përfitimet që parashikon VKM nr.182/26.02.2020, duke përfshirë personat me aftësi të kufizuara dhe kujdestarët e tyre. Duke ju referuar datës së urdhrit me të cilin kanë filluar procedurat për shqyrtimin e çështjes kryesisht nga Komisioneri rezulton se, procedura e nisur nga ky i fundit ka filluar para datës së regjistrimit të ankesës që është data 30.06.2020.

Bazuar në nenin 33, pika 4, të Ligjit nr.10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, përcaktohet se: “4. Ankesa nuk pranohet nëse: a) është anonime; b) përbën abuzim me të drejtën e ankimit para komisionerit, ose është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji; c) e njëjta çështje është duke u shqyrtuar në kuadër të një ankesë tjetër ose për të është marrë një vendim i mëparshëm dhe nuk ka të dhëna të reja; ç) është haptazi e pabazuar ose nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim; d) të gjitha faktet që përbëjnë thelbin e ankesës kanë ndodhur para hyrjes në fuqi të këtij ligji; dh) paraqitet më vonë se tre vjet nga ndodhja e diskriminimit ose më vonë se një vit nga marrja dijeni nga i dëmtuari, për këtë fakt.”

Sa më sipër, Komisioneri arrin në përfundimin se çështja që përbën objektin e kësaj ankesë aktualisht është duke u trajtuar në kuadër të një çështje tjetër dhe konkretisht në kuadër të hetimit kryesisht të filluar nga Komisioneri, hetim i cili ka nisur më para në kohë në raport me datën e regjistrimit të ankesës.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, lidhur me sa sipërcituar, Komisioneri arrin në përfundimin se nuk përmbushen kriteret ligjore për pranimin e ankesës, të përcaktuara nga neni

33, pika 4, gërma “b”, të ligjit nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” dhe për rrjedhojë ankesa nuk pranohet.

PËR KËTO ARSYE :

Bazuar në nenin 32, pika 1, gërma “a”, nenin 33, pika 4, gërma “c”, nenin 33 pika 10 të Ligjit nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës me Nr.62 Regjistri, datë 30.06.2020, që i përket ankuesve znj.E.K, znj.E.B, znj.S.D, znj.K.N, z.Gj.H, znj.E.R, znj.F.P, znj.F.Xh, znj.A.J, znj.S.G, znj.Z.B, znj.Z.K, z.D.D.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

Shkaku: Aftësia e kufizuar, Gjendja shëndetësore
Fusha: Të mira dhe shërbime
Lloji i vendimit: Vendim mospranimi